




Republika e Kosovës Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

Në mbështetje të nenit 11 (paragrafi 1.1), nenit 5 (paragrafi 1 pika 1.5), nenit 18 (paragrafi 10 dhe 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit si dhe nenit 24 (paragrafi 11) të Rregullores nr. 02/2013 së Punës të Agjencisë kundër Korrupsionit, Drejtori i Agjencisë kundër Korrupsionit me datë 30.12.2013, mori:

V E N D I M

I. Mbyllet rasti me nr. AKK-03-3291/13, për z. Muharrem Bajraktari – Prokuror i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Pejë, për shkak se zyrtari i lartë publik ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në të cilën ndodhej.

II. Rasti mund të rihapet në çdo kohë kur mund të paraqiten rrethana të reja.

A r s y e t i m

Rasti i Hapur nën dyshimin e bazuar për Konflikt Interesi në Ushtrimin e Funkcionit Publik për zyrtarin e lartë, z. Muharrem Bajraktari – Prokuror i Shtetit në Prokurorinë Themelore në Pejë, dhe njëkohësisht, person i autorizuar në biznesin privat “Avokat Muharrem Bajraktari”, të regjistruar në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë, është trajtuar sipas procedurës së paraparë në Ligjin Nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik.

Në rastin e lartëpërmendur, zyrtari i lartë z. Bajraktari është hetuar për situatë të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik dhe është njoftuar me një shkresë zyrtare nga Agjencia kundër Korrupsionit.

Pas Kësaj shkrese Zyrtari i lartë është informuar dhe është këshilluar, të bëjë ndryshimet e nevojshme në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve, në mënyrë që të shmanget situata e mundshme e konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

Zyrtari i lartë z. Bajraktari është pajtuar për situatën në të cilën ndodhet, dhe ka deklaruar se nuk e ushtron funksionin e Avokatit, dhe është i ç'regjistruar në oden e Avokatëve të Kosovës dhe si e tillë biznesi nuk është funksional, prandaj zyrtari i lartë ka pranuar rekomandimin e Agjencisë që të bëjë ndryshimet e nevojshme në Agjensinë për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë.

Zyrtari i lartë z. Bajraktari ka dërguar në Agjenci informacionin zyrtar të lëshuar nga Agjensioni për Regjistrimin e Bizneseve në Kosovë (DPKI.03- 4471/13) në të cilën vërtetohet se është bërë asgjësimi, shuarja e biznesit privat "Avokat Muharrem Bajraktari", me qka ka shmangur gjendjen e mundshme të konfliktit të interesit në ushtrimin e funksionit publik.

II. Në mbështetje të nenit 18 (paragrafi 11) të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja, andaj u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi iu dërgohet:

- Zyrtarit të lartë publik
- Drejtorit të DPK- së
- Z./znj. (zyrtari përgjegjës)

Hasan Preteni
Drejtore i Agjencisë kundër Korrupsionit

